



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0473

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Agon Ramadani - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) N.T.SH."BESI", kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të Agjencia e Statistikave të Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare të ASK-së" me numër të prokurimit 124000-23-2667-2-2-1, me 03/10/2023, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE N.T.SH."BESI" me nr. 2023/0473, e datës 06/07/2023, kurse vendimi i AK Agjencia e Statistikave të Kosovës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare të ASK-së" me numër të prokurimit 124000-23-2667-2-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik N.T.SH."BESI"

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale

Me datë 29.03.2023, Agjencia e Statistikave të Kosovës nga cilësia e saj si AK ka publikuar Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare të ASK-së" me nr. të prokurimit: "124000-23-2667-2-2-1".

Me datën 22.06.2023 autoriteti kontraktues ka publikuar njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit me arsyetimin se, citat: “Komisioni për "Servisimi dhe mirëmbajtja e Automjeteve zyrtare të ASK-se me nr 124000-23-2667-2-2-1, për shkak gjendjes së veturave në përgjithësi dhe veturës SEAT me nr të tabelave 3Z-320-01 , i cili është servisuar në Qershor 2022 dhe është jo funksional dhe i ri servisuar në tetor 2022 dhe përsëri është jo funksional , dhe bazuar në emalin e dy kolegeve Enis Berisha dhe Hajris Beqiri si ish menaxher të kontratës dhe përgjegjësve të veturave, të cilët janë shprehur të pa kënaqur me shërbimet e ofruara për mirëmbajtjen /servisimin e automjeteve sipas kërkesave /nevojave (dëshmi janë e-mailit e veturave dhe gjendja e veturave) atëherë Operatorin e konsiderojmë se nuk është i përshtatshëm për mirëmbajtjen e veturave të ASK-se”.

Me datën 26.06.2023 në AK ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim OE Ntsh "Besi" të cilën AK e ka refuzuar.

Me datë 06.07.2023, OE Ntsh "Besi" ka ngritur ankesë në OSHP me numër 2023/0473 (numër protokolli).

Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak

OSHP konstatoi se ankesat në rastin konkret, janë ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e kanë statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesat përmbajnë elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se të njëjtat i plotësojnë kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Paneli Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin vlerësues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 11.07.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportet e vlerësimit me rekomandimet:

- Ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar;

- AK ta ktheje në rivlerësim aktivitetin e prokurimit.

a Pretendimet ankimore të operatorit ankues NTSH “Besi” dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues

Pretendimi ankimor 1.

Neni 6.-Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. 2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Përgjigje ne pretendimin nr 1.

Duke u bazuar ne ofertën e OE ankues dhe pasi që është një ofertë dhe çmimet janë ne nivelin e tregut mendoj, dhe pasi që nuk mund parashikohet, andaj pretendimi i OE Ankues është i bazuar.

Pretendimi ankimor 2.

pika 40.1 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve bëhet në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP ne rregullat dhe LPP thuhet se;

Komisioni i vlerësimit ka pasur për qëllim qe tenderët te ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do ti epet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Këtë qëllim komisioni i vlerësimit nuk e ka kryer pasi për mendimin tone ai ka qene subjektiv dhe jo profesional qe arsyen nuk e dimë. Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve te RRPP Neni 59. I LPP-se- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve.

Përgjigje ne pretendimin nr 2;

Duke u thirrur ne nenin 40.12 te Rregullores nr 001-2022 -te LPP-së Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit. Andaj duke u bazuar ne arsyen e eliminimit te OE dhe kërkesës për sqarime tek AK nga ana e Ekspertit shqyrtues ku nuk kemi marr ndonjë përgjigje se a ka ndonjë Referencë negative OE dhe ofertës se prezantuar ku i plotëson nenet 68/69 le LPP-se dhe kriterëve te vendosura nga AK andaj pretendimi i OE është i bazuar.

Konstatohet në vijim, se raporti i cituar si më sipër është pranuar nga të gjitha palët, me ç ‘rast AK nuk është deklaruar për mendimin e ekspertit shqyrtues ndërsa OE është pajtuar.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

Përfundim

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin shqyrtues dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimet ankimore të OE ankues detyrojnë Panelin që aktiviteti i prokurimit në këtë rast t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit për ti përmbushur qëllimet parësore të LPP, sikurse sanksionohen ato me nenin 1, të Ligjit të cituar për shkak se gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të procedurës së prokurimit nuk është respektuar neni 59 i LPP-së dhe nuk është bërë ekzaminimi konform nenit 40.1 të RrUOPP-së.

Vlen të theksohet se lidhur me arsyen e eliminimit nga ana e AK-së me të cilën janë referuar kontratat të mëparshme, përveç faktit që sipas raportit të ekspertit nuk janë paraqitur referenca negative apo dëshmi mbi shikëputje kontratash poashtu PSH konstaton se eliminimi mbi këtë bazë nuk është i qëndrueshëm dhe konform legjislacionit në fuqi, konkretisht neni 65 pika 3 dhe 4, e poashtu 99.2 të LPP-së përcaktojnë se përjashtimi apo diskualifikimi nga pjesëmarrja në një aktivitet prokurimi është në përgjegjësi të organeve kompetente siç janë gjykatat apo vendimet e OSHP-së mbi futjen në listë diskualifikuese të OE-ve, ndërsa veprimi i AK-së mund të konsiderohet se bie ndesh poashtu me nenin 7 të LPP-së, kjo mënyrë vendimmarrje poashtu bazohet në frymën e konsistencës me rastet me situata të njëjta/ngjashme të bordit aktual (psh 406/22).

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Lidhur me tarifën ankimore, Paneli Shqyrtues vendosi konform nenit 31 pika 6, të Rregullores së Punës së OSHP, lidhur me nenin 118 të LPP.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS**
- **OE - N.T.SH." BESI "**
- Arkivës së OSHP-së: